



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr.421, datë 09.10.2020**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}**

**PËR NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR,  
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.10.2020 pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magistrat (profili gjyqtar), në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021,

**VËREN**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Z. {...} është kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 19.06.2020, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, u përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magistrat,

profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr.22, datë 16.07.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.492 prot., datë 17.07.2020 (protokolluar me nr. 3383 prot., datë 17.07.2020).

2. Me Vendimin nr.257, datë 20.07.2020, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.

3. Më datë 20.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati, z.{...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 20.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z.{...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z.{...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 257, datë 20.07.2020, që ishte data 04.08.2020 (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”

pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 28.07.2020 bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 28.07.2019, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

### **A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat**

10. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30 (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 19.06.2020, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

11. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

11.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2020), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kritereve nga ana e tyre (19 Qershor 2020), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2020). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kritereve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

11.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)<sup>1</sup>, pika 4, shkronja “c”, të Ligjit

---

<sup>1</sup> 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

**4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:**

a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

## 12. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

a) pasja nga ai e zotësisë së plotë për të vepruar, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) pasja e shtetësisë shqiptare, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti letër njoftim, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 13.05.2019, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 04.09.2020, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

---

*b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";*

***c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.***

*5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.*

*6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.*

*7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.*

c) gjendja gjyqësore, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), duke printuar në letër Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 17 datë 04.02.2020, ndërsa gjatë verifikimit, në kuadër edhe të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa nr.7733/1 prot., datë 30.07.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) disiplina në punë, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës janë depozituar, Vërtetim nr. 1222/1 datë 19.02.2020 dhe letër reference me nr.1222/2 date 19.02.2020 nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.4747/1 prot., datë 05.08.2020 e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë dhe Shkresa nr.12162/1 prot., datë 26.08.2020 Agjencisë Shtetërore e Kadastrës (Kryeministria). Letër Reference nr. 1527 datë 22.02.2019 nga Bashkia Korçë, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.5585/1 prot., datë 03.08.2020 e Bashkisë Korçë. Sipas dokumenteve kandidati nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) qenia bashkëpunëtore, informatorë, ose agjente i shërbimeve sekrete, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 20.02.2020 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

12.1. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) pasja e kriterit arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Diplomë në Drejtësi”, me nr.0154653 (seria C), datë 26.05.2011, lëshuar nga Universiteti “OVIDIUS” Kostance Rumani, Supplement Diplome më datë 26.05.2011, lëshuar nga Universiteti “OVIDIUS” Kostance Rumani. Dokumenti “Diplomë Master i Shkencave në të drejtën administrative”, me nr.0127839 (seria A), datë 10.07.2012, lëshuar nga Universiteti “OVIDIUS” Kostance Rumani, Supplement Diplome më datë 10.07.2012, lëshuar nga Universiteti “OVIDIUS” Kostance Rumani

b) pasja e përvojës profesionale, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Punë”, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 1542/9 prot., datë 07.08.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shkresa nr. 4410/1 prot., datë 05.08.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtyre dokumenteve, kandidati ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike , konkretisht si “Drejtues i nivelit të mesëm në administratën publike ” pranë Agjencisë Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë.

c) anëtarësia në parti politike, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 20.02.2020 në të cilën deklaron se nuk është anëtar e ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit anëtar i ndonjë partie politike;

ç) qenia anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 20.02.2020 në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ndërkohë që për vetë moshën e tij (i datëlindjes 13.07.1987) ai nuk mund të ketë qenë i tillë;

## **B. Për kriterin e pasurisë**

13. Për kandidatin { ... } u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidati { ... }, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 214/23 prot., datë 11.09.2020.

14.1 Sipas këtij Raporti ILDKPKI-së, kandidati { ... } ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratë së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

14.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati { ... }, duke konkluduar se për kandidatin :

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;

b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

15.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni i dërgua me Shkresën nr. 15042/9 prot., datë 07.08.2020 dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë informacioni i dërgua me Shkresën nr. 10051/1 prot., datë 17.08.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepen të gjitha të dhëna për aktivitete tregtare.

15.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 14353/1 prot., datë 10.08.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

16. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e Rajonale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

17. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

### **C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit**



18. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

19. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit<sup>2</sup>, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni<sup>3</sup>.

20. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme.

21. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi dhe depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 23.07.2020, formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

22. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1166/36 prot., datë 28.09.2020, protokolluar me aktin nr.3647/39, datë 29.09.2020 përgjigjet zyrtare të 29 (njëzetënëntë) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, apelit si dhe përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se për kandidatin {...}, nuk është regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jo përfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

---

<sup>2</sup> Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

<sup>3</sup> Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

23. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5543/1 prot., datë 01.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.3631/1, datë 02.10.2020, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

24. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidati: “- *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 23.7.2020; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme*”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

25. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtores ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e

informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;

dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e tij për në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.

### **III. KONKLUSIONE**

26. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

27. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

### **PËR KETO ARSYE**

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI**

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**